

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

**07.12.2023
Ora 12:03**

RENDI I DITËS

Projektvendime: “Për plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafii KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. V. Ballgjini.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, në seancën e sotme publike kemi në rend dite këto çështje: projektvendim për plotësimin e vakancave në Këshillin e Bashkisë Has dhe në këshillin e Bashkisë lezhë si dhe dy projektvendime që lidhen me miratimin e gjetjeve nga raporti i auditimit të fondeve publike të përfituara dhe shpenzime të partive politike për vitin kalendarik 2021 si dhe të raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Po i relatoj të dyja bashkë. Këshilli i Bashkisë Has dhe Lezhë kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, në këshillat e tyre. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidatët vijues nga listat shumemërore të Partisë Aleanca Progresiste LZHK dhe Partisë Kristian Demokrate, kanë plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*


formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të të dy kandidatëve për këshilltarë, rezulton se asnjë prej tyre nuk ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim të ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore për të dy kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiakë Lezhë dhe Has. Në përgjigje të kërkesës sonë DPGJC dhe DPGJGJ kanë dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët e mësipërm. Rezulton se kandidatët nuk kanë ndryshime në përbërës të gjendjes civile dhe nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Mbështetur në pikën 2, Kreu V, të vendimit 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dy kandidatët për anëtarë të këshillave të bashkive Has dhe Lezhë nuk janë në kushtet e ndalimit dhe moszgjedhshmërisë së tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimet për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Has, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Aleanca Progresiste LZHK, zotin Hamit Sheta.
- Plotësimin e vakancës për Këshillin e Bashkisë Lezhë nga lista shumemërore e subjektit Partia Kristian Demokrate, zonjën Silvana Kola.

Vendimi nr. 821, 822

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

**07.12.2023
Ora 12:06**

RENDI I DITËS

Projektvendimi: “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafii KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. V. Ballgjini.


Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te projektvendimi “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”.

Znj. V. Ballgjini: Raporti i gjetjeve përmban të gjitha gjetjet që janë bërë nga auditimi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka bërë fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021. Nga ky raport është bërë një përmbledhje brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të gjitha partitë që rezultojnë të regjistruara në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku janë të regjistruara regjistruara njëqind e tridhjetë e dy parti politike. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dërguar shkresë njëqind e tridhjetë e dy partive politike nga këto tridhjetë e shtatë parti politike e kanë marrë njoftimin ndërkohë që për nëntëdhjetë e pesë parti politike është kthyer zarfi për shkak të pasaktësisë së adresës. Janë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

administruar dyzet e gjashtë raporte financiare të dorëzuara nga partitë politike. Kemi bërë dhe një krahasim me vitin 2020. Nëse për vitin 2021 kemi 46 raporte, në vitin 2020 ishin vetëm 21 raporte të dorëzuara nga partitë politike. Pas dorëzimit të raporteve financiare nga partitë politike, u caktuan ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike. Ekspertët kontabël të licensuar, referuar afateve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021, depozituan raportet e auditimit për, po themi njëqind e tridhjetë e dy parti politike, meqenëse është detyrimi ligjor që të bëhen njëqind e tridhjetë e dy auditime. Pas administrimit të raporteve të sipërcituara, KQZ evidentoi mospërputhje në lidhje me ligjin për “Partitë Politike”, si dhe aktet nënligjore.

- Mosdorëzimi i raporteve financiare vjetore nga tetëdhjetë e gjashtë parti politike;
- Moskryerjen e auditimit për tetëdhjetë parti politike për shkak të adresave jo të sakta;
- Moskryerjen e auditimit për shtatëmbëdhjetë parti politike pasi kanë paraqitur pasqyra financiare me vlerë 0, për këtë arsye nuk mund të shprehet një opinion lidhur me procesin e auditimit nga audituesit ligjorë;
- Dy parti politike nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare në KQZ por pasi kanë kontaktuar me audituesin ligjor kryetarët e këtyre partive politike kanë deklaruar se nuk kanë pasur asnjë të ardhur apo shpenzim;
- Dy parti politike kanë kryer shkelje të dispozitave të financimit;
- Moskryerja e auditimit për katërmëdhjetë parti politike pasi nuk kanë bashkëpunuar me audituesit ligjorë, edhe pse në KQZ kanë dorëzuar raportet financiare;
- Moskryerja e auditimit për një parti politike për shkak se kjo parti nuk ka likuiduar audituesin ligjor të vitit paraardhës;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

- Moskryerja e auditimit për një parti politike pasi partia është shpallur në listën e subjekteve me statusin pasiv nga organet tatimore dhe rezulton e tillë edhe sot që merret vendimi.

Gjithashtu nga raportet e dorëzuara nga audituesit ligjorë për partitë politike, audituesi është shprehur me opinion rezervë për mosdeklarimin e dhurimeve në natyrë për qeranë e zyrave të fushatës zgjedhore të datës 25 prill 2021 për Partinë Socialiste të Shqipërisë. Ndërkohë që këto zyra rezultojnë të deklaruara në raportin e fushatës zgjedhore. pasi është dërguar projektvendimi partive politike për njohje, kryefinancieria e Partisë Socialiste të Shqipërisë, nëpërmjet e-mail-it dërguar KQZ, ka sjellë një informacion shpjegues ku thekson se: kur është mbyllur bilanci i vitit 2021 nuk është ngarkuar me shpenzime dhe të ardhura të fushatës për kandidatë, por e kanë cilësuar në materialin shpjegues të bilancit, të ardhura dhe shpenzimet e tyre. Gjithashtu për zyrat elektorale me hua/përdorje të fushatës, duke menduar se janë dhurime në natyrë, e kanë deklaruar vetëm në raportin e zgjedhjeve të vitin 2021. Për sa i takon këtij konstatimi, audituesja e ka lënë detyrë, që në bilancin e vitit 2022 të jenë të integruara dhe fushata zgjedhore dhe është integruar në fushatën zgjedhore të datës 6 mars. Ky projektvendim është përcaktimi i masave administrative për partitë politike të cilat kanë shkelur rregullat dhe formatet e standardizuara të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për sa më lart në këtë relacion. Ju lutem vendimmarrjen tuaj!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, bazuar në gjetjet e raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021, vendosim sanksion administrativ, bazuar në nenin 23/4, pika 1 të ligjit “Për Partitë Politike” në masën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për këto parti politike:


- “Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

- “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”;
- “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”;
- “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”;
- “Partia Punës Shqipërisë”;
- “Partia Aleanca Demokracia e Re”;
- “Partia Përparimi Kombëtar i Shqipërisë”;
- “Partia e Blertë Shqiptare”;
- “Partia Uniteti Kombëtar”;
- “Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë”;
- “Partia Universale Shqiptare”;
- “Partia Liberale Shqiptare”;
- “Partia Ekologjike”;
- “Partia Socialpunëtore e Shqipërisë”;
- “Partia Socialreformiste e Shqipërisë”;
- “Partia Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare”;
- “Partia Lëvizja Demokratike për Vlera, Mirëqënie, Progres”;
- “Partia Alternative Republikane”;
- “Partia Konservatore”;
- “Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar”;
- “Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare”;
- “Partia Triumfi i Legalitetit”;
- “Partia Rimëkëmbja Kombëtare”;
- “Partia Centriste Mirëqënies Popullore Shqiptare”;
- “Partia Pajtimit Kombëtar”;
- “Partia Komuniste e Shqipërisë (e rindërtuar)”;
- “Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare”;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

- “Partia Alternativa Liberale e Shqipërisë”;
- “Partia Komuniste e Shqipërisë”;
- “Partia e të Majtës Demokratike Shqiptare”;
- “Partia Ambientaliste”;
- “Partia Aleanca Nacionale Shqiptare”;
- “Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare”;
- “Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare”;
- “Partia Demokrate e Re”;
- “Partia Mendimi i Djathtë Liberal”;
- “Partia Demokracia Paqësore e Shqipërisë”;
- “Partia Aleanca Socialiste Shqiptare”;
- “Partia Sigurisë Kombëtare Shqiptare”;
- “Partia Shpresa Demokrate”;
- “Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori”;
- “Partia Demokratike Peza Gjirokastrë e Shqipërisë”;
- “Partia Integritit Social Kombëtar Shqiptar”;
- “Partia Lidhja e Blertë”;
- “Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut”;
- “Partia Shqiptare Atdheu”;
- “Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare”;
- “Partia e të Drejtave të Mohuara”;
- “Partia e Çështjeve Shqiptare”;
- “Partia Fronti i Majtë
- “Partia Shqipëria e Re”;
- “Partia Lëvizja Elitare Kombëtare”;
- “Partia Shqiptare e Rindërtimit”;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

- “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”;
- “Partia e të Drejtave të Mohuara – e Re”;
- “Lista për Shqipëri Natyrale”;
- “Partia Aleanca Kombëtare”;
- “Partia Progresi Social Kombëtar”;
- “Partia Aleanca për Europën”;
- “Partia Demokratike e Bashkimit Myslyman të Shqipërisë”;
- “Partia Ligj dhe Drejtësi”;
- “Partia G99”;
- “Partia Toleranca e Re e Shqipërisë”;
- “Partia Aleanca Europiane Ekologjike”;
- “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”;
- “Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve”;
- “Partia Personat me Aftësi të Kufizuar”;
- “Partia Lëvizja Shqipëria e Re”;
- “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi e Shqipëtarëve”;
- “Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres”;
- “Partia Aleanca Kuq e Zi”;
- “Partia Forca Rinia”;
- “Partia Shkodra 2015”;
- “Partia Sfidë për Shqipërinë”;
- “Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare”;
- “Partia Indipendentëve të Shqipërisë”;
- “Partia Nacional Demokrate e Shqipërisë”;
- “Partia Lidhja Popullore Shqiptare”;
- “Partia Nacionaliste Shqiptare”;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

- “Partia e Djathtë Demokratike e Shqipërisë”;
- “Partia Drejtësia Shoqërore;
- “Partia Progresi Demokratik”;
- “Partia Mbrojtja e të Drejtave Kombëtare”;
- “Partia e Re Socialiste e Shqipërisë”;
- “Partia Ideali Demokratik Shqiptar”;
- “Partia Lëvizja për Demokraci”;
- “Partia Ideali Komunist”;
- “Partia e Biznesit Shqiptar”;
- “Partia Aleanca Popullore për Drejtësi”.

Për shkelje të parashikuara nga neni 23/4, pika 2 të ligjit “Për Partitë Politike” do të sanksionohen në masën 1 000 000 (një milion) lekë:

- “Partia Bindja Demokratike”;
- “Partia Demokratike”;
- “Partia Zgjidhja”;
- “Partia Balli Kombëtar”;
- “Partia Kristian Demokrate”;
- “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”;
- “Partia Integrimi Social Kombëtar Shqiptar”;
- “Partia Sigurisë Kombëtare Shqiptare”;
- “Partia e të Drejtave të Mohuara – e Re”;
- “Partia Ligj dhe Drejtësi”;
- “Partia Aleanca Popullore”;
- “Partia Aleanca Kuq e Zi”;
- “Partia Shkodra 2015”;
- “Partia Aleanca Europiane Ekologjike”.


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Vendimi nr. 823

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendimi: “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. V. Ballgjini.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te projektvendimi që ka të bëjë me vlerësimin e gjetjeve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”.

Znj. V. Ballgjini: Më 6 mars 2022 u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në 6 bashki. Në këto zgjedhje u regjistruan pesë subjekte zgjedhore, nga të cilët tre parti politike: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Demokratike, Partia Lëvizja e Re dhe koalicioni Shtëpia e Lirisë i përbërë nga dy parti politike, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (sot Partia e Lirisë) dhe Partia Demokristiane. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 27.01.2022 caktoi njëzet monitorues për monitorimin e fushatës zgjedhore, të cilët çdo dhjetë ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës dorëzonin raportet e ndërmjetme në KQZ, si dhe shtatë ditë pas përfundimit të zgjedhjeve dorëzuan raportin


**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

përfundimtar. Për periudhën shkurt 2022 deri më 13 mars 2022 janë administruar gjashtëdhjetë raporte monitorimi nga njëzet monitoruesit e caktuar, si dhe shtatë raporte shkeljesh për të cilat është marrë vendim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Me vendimin nr. 26 datë 17.03.2022, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 mars 2022”, KQZ u dërgojë shkresë për rikujtim të detyrimit ligjor për dorëzimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore të gjitha subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 6 mars 2022. U administruan pesë raporte financiare të fushatës zgjedhore të dorëzuara nga subjektet zgjedhore. Në total gjatë fushatës zgjedhore pesë subjektet zgjedhore kanë shpenzuar 32.877.889,3 (tridhjetë e dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë presje tre) lekë. Financimet jo publike për pesë subjektet zgjedhore kanë qenë në total 32.897.000 (tridhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë. Pas dorëzimit të raporteve financiare nga vetë subjektet zgjedhore, KQZ caktoi ekspertët kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore të datës 6 mars 2022”. Audituesit ligjorë, referuar afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, depozituan raportet e auditimit për pesë subjekte zgjedhore që morën pjesë në zgjedhje. Pas administrimit të raporteve të sipërcituara KQZ evidentoi mospërputhje në lidhje me Kodin Zgjedhor si dhe aktet nënligjore për partitë politike si më poshtë vijon:

- Mosdorëzim i raporteve financiare nga kandidatët e listave shumemërore;
- Mungesë e dokumentave justifikuese mbi shpenzimet e kryera gjatë fushatës nga subjektet zgjedhore;
- Mosbërja transparente e burimeve të financimit;
- Pranimi i dhurimeve me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë jo nëpërmjet llogarisë bankare të deklaruar;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

- Mosbashkëpunim me KQZ duke mos i kthyer përgjigje kërkesave të saj.
- Gjithashtu u evidentuan mospërputhje për reklamat politike në media:
- Tejkalim i 90 minutave të lejuara sipas nenit 84, pika 5 e Kodit Zgjedhor nga OSHMA-të;
 - Mosdorëzimi i tarifave zyrtare nga OSHMA-të në Komisionin Qendror të Zgjedhjes sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor;

- Mosbashkëpunim me KQZ duke mos i kthyer përgjigje kërkesave të saj.

Në seancën pulike të datës 6 Tetor 2023 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, organizata KRIIK ka depozituar rekomandime shtesë lidhur me projektvendimin. Rekomandimet e KRIIK u morën në shqyrtim dhe pas verifikimeve përkatëse rezultoi:

- Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Demokratike e Shqipërisë nuk kanë deklaruar të gjitha zyrat zgjedhore të hapura për fushatë zgjedhore, gjë e cila është vërtetuar dhe nga raportet e monitoruesve të fushatës zgjedhore.
- Kandidatja e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, znj. Emirjana Sako, kandidati i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Edison Memolla, kandidati i subjektit zgjedhor, Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, z. Ardian Muka si dhe kandidati i subjektit zgjedhor, Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, z. Bardh Spahia i kanë dhuruar vetes vlerë më të madhe se 50 mijë lekë cash dhe jo nëpërmjet llogarisë së posaçme bankare.

Ky projektvendim është përcaktimi i masave administrative për subjektet zgjedhore të cilët kanë shkelur rregullat dhe formatet e standardizuara të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe përcaktimi i masave administrative për OSHMA-të që kanë shkelur detyrimet e Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër projektvendimi për shqyrtim dhe miratim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, do t'i propozojmë vendosjen e sanksioneve, Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve sanksion për:

- “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në vlerën 3 000 000 (tre milion) lekë.
- “Partia Demokratike”, në vlerën 3 000 000 (tre milion) lekë.
- Përsëri “Partia Demokratike”, për shkelje të nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor, në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

Për shkelje të nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor “Partia Demokratike”, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë.

- T'i propozohet Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosja e sanksioneve administrative, për kandidatët për kryetarë bashkie:

- Zotin Edison Memolla;
- Zonjën Emirjana Sako;
- Zotin Bardh Spahia dhe
- Zotin Ardian Muka për shkelje të nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
- Vendosjen e masës administrative me gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për të gjithë operatorët audiovizivë lokalë:

- | | |
|-------------------|-----------------------|
| - ADTN; | - Tv Berati; |
| - ABEG Tv; | - Tv Channel 1; |
| - Club Tv; | - Tv Channel 7; |
| - Era Digitalb; | - Tv Jug; |
| - Glob Tv; | - Tv Klaudiana; |
| - One Tv Vlora; | - Tv Kopliku; |
| - Shijak Tv; | - Tv Lobi; |
| - Tv BS; | - Tv Mati; |
| - Tv 6+1; | - Tv Premium Channel; |
| - Tv Antena Nord; | - Tv Rozafa Motiv; |

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 07.12.2023*

- Tv Saranda; - TTV;
- Tv Sot 7; - Tv Re.AL;
- Tv Star Plus; - Syri Tv.
- Tv UTV Education;
- Syri Tv edhe për shkelje të neneve 92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;
- Top Channel, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për shkelje të neneve 92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.
- Star Plus, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Këto janë!

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.
- Çështje të tjera nuk kemi!?

Z. Y. Merkaj: Jo!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, ditë të mbarë! Seanca mbyllet!

Vendimi nr. 824

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

